



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2615 prot.

Himarë, më 30.05.2022

VENDIM

Nr. 27 datë 27.05.2022

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË ISH-GODINËS SË SHKOLLËS 9- VJEÇARE "HYSEN CINO" NË NJËSINË ADMINISTRATIVE HORË-VRANISHT

(PAS RISHQYRTIMIT)

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenit 25, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, VKM-së nr. 362, datë 05.06.2003 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Komunës Horë- Vranisht", ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, udhëzimit nr. 6756, datë 03.09.2015 për "Zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", kërkesës nga shoqëria "G UR THEMELI" GTH SHPK me nr.681 prot., datë 22.02.2021, dhe të nenit 16, pika 2, e ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", **Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e dt:27.05.2022 pasi shqyrtoi projektvendimin e paraqitur nga zyra juridike miratoi me 14 vota pro,0 kunder,0 abstenim dhe si përfundim**

V E N D O S I:

1. Të japë pëlqimin për dhënien me qira të ish-godinës së shkollës 9- vjeçare "Hysen Cino" në Njësinë Administrative Horë-Vranisht, me qëllim përdorimin e tyre për veprimtari në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese , për një periudhë 20 vjeçare.

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar).

3. Për zbatimin e këtij vendimi, dhe ndjekjen e korresponcencës për kryerjen e procedurave të mëtejshme dhe përcjelljen e dosjes në Ministrinë e Financave si përfaqësues i pronarit të pronës publike, ngarkohet drejtoria juridike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 16, pika 2, e ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

